

NJOFTIM

Drejtuar Z/Znj. _____ Aksioner/Perfaqesues/e i/e Aksionerit _____)

Per nje shtese ne rendin e ditës te mbledhjes se Asamblesë se Aksionareve date 29 Tetor 2018 ora 12.00, sipas kërkesës se paraqitur nga aksioneret Z.Maltin Korkuti dhe Znj. Monika Milo ne përputhje me Nenin 139 «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare». Pas kësaj kërkesë, rendi i ditës se mbledhjes date 29 Tetor 2018 ora 12.00 behet si me poshtë:

1. Propozim per miratimin e emetimit te ri te obligacioneve afatgjate të konvertueshme në aksione të zakonshme te Bankes Credins:

- a. Vlera totale e emetimit do të jetë 400.000.000 Lek, 500.000 Euro dhe 1.000.000 USD.
- b. Vlera nominale: 1.000.000 Lek, 10.000 Euro dhe 10.000 USD.
- c. Obligacionet e emetuara nuk do të jenë të garantuara nga asnjë mjet sigurimi apo garancie nga Emetuesi apo persona të tretë.
- d. Obligacionet e Bankes Credins do emetohen me "par value", me cmimin qe i korrespondon vleres nominale te cdo prerje obligacioni. Kjo do te thote qe çmimi i blerjes se tyre eshte i barabarte me 100% te vleres nominale. Shumat e obligacioneve jane me prerje minimale ne 10,000 (dhjete mije) euro, 10,000 (dhjete mije) Usd dhe 1.000.000(nje milion) Lek.
- e. Raporti i konvertimit percakton numrin e aksioneve qe perfitohen nga konvertimi i secilit obligacion. Konvertimi i shumes se obligacioneve ne aksione behet bazuar ne cmimin e aksionit.

Nr. Aksionit = Vlera obligacionit/Cmimin e aksionit

- f. Cmimi i aksionit eshte vlera kontabel (book value) per aksion qe rezulton, ne kohen kur behet kerkesa per konvertim nga palet, sipas pasqyrave financiare te 3 mujor-it me te fundit, te publikuara.

E drejta e konvertimit ne aksione mund te ushtrohet nga zoteruesi i obligacioneve per te gjithë vleren ose nje pjese te Obligacioneve te Konvertueshme ne aksione te zakonshme, por ne asnje rast kjo vlere nuk eshte me e vogel se vlera nominale e percaktuar per nje obligacion. E drejta e konvertimit ne aksione mund te ushtrohet nepermjet paraqitjes se kerkeses se konvertimit te Obligacioneve te Konvertueshme ne aksione te zakonshme (ne vijim "Kerkesa e Konvertimit"), prane Bankes Credins Sha. Kerkesa e Konvertimit duhet te paraqitet ne cfaredo dite pune. Banka Credins ka te drejten e miratimit ose jo te konvertimit te obligacioneve ne aksione te zakonshme. Ne rast te dhenies se miratimit nga ana e Bankes, te konvertimit te obligacioneve ne aksione te zakonshme, kjo e fundit pergatit kontraten perkatese.

Banka gezon te drejten t'u kerkoje ne cdo kohe, pergjate periudhes se kohezgjatjes se obligacionit, me shkrim, zoteruesve te obligacioneve, konvertimin e pjesshem apo te plote te obligacioneve te nenshkruara dhe te paguara, ne aksione te zakonshme. Ne rast te konfirmimit per pranimin e kerkeses nga zoteruesi i obligacioneve, banka pergatit kontraten perkatese.

- g. Fondet nga shitja e obligacioneve do të përdoren nga emetuesi ne aktivitetin e ushtrimit të veprimtarisë së tij dhe veçanërisht ne dhënien e kredive të formave të ndryshme si edhe në investime karakteristike të këtij aktiviteti.
- h. Kohëzgjatja e obligacioneve të jetë 7 vjet. Nuk parashikohen kushte te rimbursimit paraprak. Ne baze te Rregullores se Bankes se Shqipërisë per Kapitalin Rregullator te

Bankes, kreu IV, neni 38 dhe neni 39, Banka e Shqiperise mund te jape miratimin paraprak bankes per te shlyer instrumentet e kapitalit te nivelit te pare dhe te dyte, perpara pese viteve nga data e emetimit te tyre, vetem kur jane plotesuar kushtet e parashikuara ne paragrafin e pare te Nenit 39, si dhe jane plotesuar kushtet e percaktuara ne shkronjen "a" dhe "b" te paragrafit te trete te ketij neni.

- i. Mbajtësi i obligacionit do te marre interesa kuponash gjashtëmujorë. Shuma e kuponit do të llogaritet duke aplikuar mbi vleren nominale nje norme interesi fikse. Formula per llogaritjen e kuponit të jetë si me poshte: Kuponi = vlera nominale e obligacionit * i/2, ku: i është norma e interesit vjetor te kuponit.
- j. Pagesa e interesave do te behet nga Kujdestari i Titujve perzgjedhur nga Banka, i cili do kryejë shërbimin e Kujdestarise se obligacioneve te emetuara nga Banka Credins Sha sipas urdher pageses se dhene nga Banka Credins Sha. Interesi do te shlyhet ne te njejten monedhe me monedhen e investimit.
- k. Ne momentin kur zoteruesi i obligacioneve do ushtroje te drejten e konvertimit, obligacionet nuk do prodhojne me interesa duke filluar nga momenti i regjistrimit te aksioneve sipas legjislacionit ne fuqi.
- l. Vlera e kapitalit te nënshkruar, te paguar e Bankes me 30.09.2018 është 8.476.243.099,35 leke. Emetimi i ri i obligacioneve ne total ze 6.74% te kapitalit aksionar te nenshkuar dhe paguar.
- m. Shlyerja e kapitalit dhe pagesa e interesave garantohen vetëm nga kapitali i emetuesit. Titujt nuk përmbajnë asnjë garanci reale apo personale te personave te trete dhe nuk janë te lidhur me fondin e garancisë se depozitave ne mbrojtje te depozituesve nga Agjencia e Sigurimit te Depozitave.
- n. Struktura e emetimit dhe numri i obligacioneve:

Emertimi i Obligacionit te konvertueshme ne aksione te zakonshme	OBLIGACION AFATGJATE ME NORME INTERESI FIKSE (BORXH I VARUR)- TE KONVERTUESHME NE AKSIONE TE ZAKONSHME
Kohezgjatja	7 vjet
Cmimi i Emetimit	100% e vleres nominale
Frekuenca e kuponit	Gjashtemujore
Perqindja e Kuponit	Ne LEK, 7Y, norme fikse, 5.80%; Ne EUR, 7Y, norme fikse, 3.50%; Ne USD, 7Y, norme fikse, 4.00%;
Rimbursimi	100% Vleres Nominale ne maturim
Garanci per Obligacionin te konvertueshme ne aksione te zakonshme	Nuk eshte e parashikuar
Shlyerje perpara maturimit	Me miratim paraprak nga Banka e Shqiperise sipas Nenit 38 dhe Nenit 39, Kreu IV, te Rregullores "Per kapitalin rregullator te Bankes" miratuar me vendim te Keshillit Mbikeqyres te Bankes se Shqiperise nr 69, date 18.12.2014, e ndryshuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.19, datë 04.03.2015.
Transferueshmeria	Po

Ligji	Obligacionet rregullohen nga Ligji Shqiptar
-------	---

- o. Ne ligjin nr.9662, date 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", nenkreu II, gjen rregullim procedura e likuidimit vullnetar dhe likuidimit te detyruar te bankes ose deges se bankes se huaj. Ne nenin 121 te ketij ligji eshte rregulluar rradha e shlyerjes se detyrimeve. Për detyrimet e tjera të pretenduara kundrejt bankes, ku perfshihet edhe borxhi i varur, rradha e shlyerjes se tyre, renditet sipas pikes 1.d te ketij neni. Ne rast se brenda afatit te maturimit, obligacionet e emetuara, do te konvertohen ne aksione te zakonshme te bankes, rradha e shlyerjes se detyrimeve ndaj aksionareve të bankes, do te behet sipas nenit 121/4 "Çdo aktiv i mbetur pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve të pretenduara, shpërndahet midis aksionarëve në raport me të drejtat dhe pjesëmarrjen e secilit në kapitalin e bankës ose degës së bankës së huaj".

Lista me emrat e investitoreve te mundshem i bashkengjitet ketij Vendimi

2. Ngarkohet Drejtoria te marre miratimin pranë Autoritetit te Mbikëqyrjes Financiare dhe Bankës se Shqipërisë, te nenshkruaje kontratat dhe cdo dokumentacion tjetër lidhur emetimin e obligacionve te siperpermendur ne piken 1 dhe te beje regjistrimin prane QKB.
3. Propozim per marrjen ne pronesi te kolateraleve te debitoreve te Bankes Credins si rezultat i procesit permbarimor.
4. Autorizohet Drejtoria te ndjete te gjitha hapat ligjore dhe te nenshkruaje cdo akt, kerkese, aplikim, kontrate, etj., deri ne kompletimin e procesit te marrjes ne pronesi te pasurise se siperpermendur ne piken 3.
5. Propozim per miratimin e shitjes se nje pjese te aktivitetit te bilacit te Bankes Credins sh.a.

Jeni të lutur të paraqiteni. Ju Faleminderit.

Maltin KORKUTI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Sqarojmë se:

Referuar Statutit të shoqërisë dhe Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare» Aksionerët kanë këto të drejta dhe detyrime:

- Aksionarët, të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, mund t'u drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë, të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rend të ditës. Në kërkesë duhet të jepen arsyet dhe objektivat, si edhe çështjet për të cilat duhet të marrë vendime asambleja e përgjithshme. Nëse kërkesa nuk është pranuar, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë e përgjithshme e të vendosin çështje në rendin e ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 137 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare»

- Nëse asambleja e përgjithshme, në kundërshtim me sa më sipër, nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk përfshihet në rendin e ditës, secili prej aksionarëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse organet drejtuese nuk përmbushin kërkesat e tyre brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojnë shoqërisë blerjen e aksioneve të zotëruara prej tyre, sipas nenit 133 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare».

- Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, dhe thirrja u është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, në të njëjtat mënyra, me të cilat është kryer njoftimi i parë.

- Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një prokure nga një aksionar tjetër, apo nga një person i tretë.

- Administratorët dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.

- Prokura, mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

- Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.

- Asambleja merr vendimet nëpërmjet votimit të hapur.

- Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës apo administratorëve, asambleja e përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga aksionarët, të cilët zotërojnë një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

- Kopje të dokumentave dhe projekt-vendimeve bashkëlidhur me këtë njoftim do të gjeni edhe pranë Selisë së shoqërisë, nëpërmjet një kërkesë me shkrim të depozituar pranë shoqërisë "Credins Bank" sh.a.